

THE CULTURE OF ALBANIAN MEMORI MYTHOLOGICAL FIGURE OF BREVA MITI PËR BREVËN

Nazmi BEQIRI¹

^{1*}*Corresponding author e-mail: nazmi.beqiri@unite.edu.mk*

Abstract for the myth Breva

The myth “Breva” is a fairy tale of ancient times before Solomon, because besides the way the description of life that resembles that time, within it is also the suffering of metamorphosis. Any story inside, whether it is about evil or pleasant events, in an astonishing way (even for Today’s), presents an excellent way of education. Within the family for whom the fairy tale, an unwanted girl is born, whom they name Breva who from parental carelessness for her, she does not die, but undergoes metamorphosis and turns into a monster that destroys everything while her parents repent of their mistakes before God and the evil disappears, while Breva returns to a good and very beautiful girl, where fairy tales also end, leaving many messages behind.

Abstrakt për mitin e Brevës

Miti “Breva”, është një rrëfim e kohës së lashtë e para periudhës së Solomonit, ngase pos mënyrës së përshkrimit të jetesës që i gjason asaj kohe, brenda saj gjendet edhe fenomeni i metamorfozës. Çdo rrëfim brenda, qoftë i ndodhimeve të liga, apo të këndshme, në mënyrë mahniëse (edhe për kohën e sodit), paraqitet një mënyrë e shkëlqyeshme e edukimit njerëzor. Brenda familjes për të cilën flitet në rrëfim, lind një vajzë e padëshirueshme për prindërit, e të cilën e pagëzojnë me emrin Breva e cila nga mospërkujdesja e prindërve për të, ajo jo që nuk vdes, por vazhdon të rritet dhe të tjetërsohet duke u shndërruar përmes metamorfozimit në një përbindëshe tinzare që shkatërron çdo gjë derisa prindërit e saj pendohen për gabimet e veta para Zotit dhe e keqja zhduket, kurse Breva rikthehet në një vajzë të mirë dhe shumë të bukur, ku përfundon edhe rrëfimi duke lënë shumë porosi pas vetes.

Hyrje

Miti për Brevën, fletë për një familje që pos sefasë, nuk donin diçka tjetër. Ata nuk e deshën edhe vajzën e vete të posalindur, sa, Perënidia, në vënd që t’ia merrte shpirtin, e shndërron atë në përbindësh e cila paraqet rrezik edhe për familjen e vet.

Ky hall i madh familjar edhe për tërë krahinën zgjidhet pas pendimit dhe vetdijësimit të prindërve.

Ç’është Breva?

Në fjalorin gjuhës sonë e gjejmë fjalët: brej, brejtës, brejtje, brenë, që i jepet kuptimi i të përtypurit, i të coptuarit, të grryerit, grimtësimit, etj, e cila fjalë ka përdorim të gjërë në të gjitha trojet shqiptare. Ajo, ka një përdorim mjaft të gjërë edhe në tregime e këngë popullore dhe kam pershtypjen se është e kuptueshme për të gjithë. Në disa raste thuhet se Breva është një lloj

gjarpëri. Por mënyra e ushqimit të gjarpërinjëve nuk është brejtja, por gëlltitja dhe është alogjike që të pranohet si e vërtetë. Mund të ketë edhe ndonjë emërtim tjetër i marrur ngandonjë gjallesë, por edhe duke e ditur tregimin për Breven nuk ia kisha bërë pyetje vetes, se kush e bën brejtjen? Madje as atëherë kur me ëndje e dëgjoja këngën për Mic Sokolit: "...kalun vitet kalon një shekull / koha brenë (grryen) gurë e hekur / erdh ndër kohëra e iu vesh trollit / Xhamadani i Mic Sokolit".

Duke e ditur se veprimin e bën vepruesi e në këtë rast e bënte brejtjen dhe nuk e kishim emrin e brejtësit, ngaqë nuk kishte ndonjë shpjegim në fjalorin tonë gjuhësor (si dhe shumë fjalë të tjera që na mungojnë), vendosa që ta publikoj se ajo që brenë në këtë rast është një vajzë me emrin Breva që domosdoshmërisht ishte shndërruar në përbindëshe dhe brente çdo gjë që kishte përpara.

Se si e mori ajo këtë emër e mësova nga rrëfimet për te, që jo rrallë herë kjo rrëfenjë, gojëdhënë, tregohet nga plakat e madje edhe në dhoma burrash gjatë stinës së dimrit.

Vjetërsia e mitit

Në këtë mit, flitet për një familje tek e cila, brenga kryesore e saj ishte zefku e më pastaj, sigurimi i ushqimit, veshmbathjes dhe strehimit. Nuk përmenden armiq të kurfarë natyre. Nuk përmenden fjalët: qytet, luftë, grabitqar e cila gjë na bën me dije se kjo gojëdhënë i takon kohës paraqytetëruese. Këtë fakt e përforcon përkujdesja e njerëzve për njëritjetrin, duke e lënë të kuptohet se kjo përkujdesje bëhej atypëraty e jo si sot.

Se kjo gojëdhënë është e kohës paraqytetëruese është edhe rasti i fenomenit të metamorfozës e cila dukuri përfundon me kohën e Solomonit e të Davudit, nga e cila kohë në legjendat tona, thuhet se: "nga ajo kohë, exhinet neve na shohim, ndërsa ne nuk mundemi t'i shohim ato". E cila frazë në brendinë e vet paraqet një paralelizëm jetësor, që me gjuhën e sotme e quajmë "dimension".

Vjetërsinë e gojëdhënës e argumenton edhe mosdija e planifikimit familjarë, të cilën gjë e lejojnë disa besime (religjione). Gati në të gjitha besime, është një fuqi absolute që krijon dhe zhduk. Nga të gjitha besimet del se Perëndia e krijoi edhe njeriun si mëkëmbës të vetin në tokë, të cilin e drejton në të gjitha punët, por edhe në planifikimin e familjes. Madje te disa prej tyre fëmija i dhurohet prindërve si dhuratë e cila duhet të duhet e të çmohet.

Të gjitha rrëfimet që thërrasin në besim, siç dihet, këto thirrje bëhen përmes flijimeve të ndryshme, përmes ndihmes që u jep të tjerëve, përmes dhunës, forcës, fuqisë dhe përmes mrekullive të ndryshme që i posedonte thirrësi. Në këtë gojëdhënë mitologjike, thirrja nuk bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë por përmes sprovës foshnjës së lindur dhe përmes pendimit për largimit nga rruga njerëzore.

Këtu fillon thirrja, edukimi, përmes detyrimit në gjykimin për vetën e në këtë rast për prindërit. Pastaj fillon të nxitet dhëmshuria për fëmijën për të cilin deri më atëherë nuk ishin kujdesur. duke vazhduar që të ngjallë frikë e pasiguri, kështu krijuesi popullor i asaj kohe, sigurinë e sjellë në një mënyrë fare të thjeshtë: kthimi në humanitet, apo në obligueshmërinë e vet njerëzore, pendimin për të këqijat që i ka bërë dhe në bindjen për Perëndinë.

Veçantia e kësaj gojëdhënë është se, thërret në zgjuarsin, në përgjegjësi njerëzore, devotshmëri, në vetëdije njerëzore dhe në bindshmërinë e Perëndisë. Një thirrje të këtillë për besim, për devotshmëri dhe humanitet të asaj kohe, nuk e kam dëgjuar e as lexuar dikund. Se është krijim popullor i veçantë dhe se paraqet mbamendjen e zanafillës së njerëzimit, gjithnjë me theks nga mbamendja popullore e traditës së brezave, sikurse që është ruajtur "oda sajbi" e që është e një kohe më të re se miti për Brevën, por të dyja bashkë, janë treguese të një qytetërimi dominant për kohën. Zatën këtë e zbërthen edhe logjika, pasi që në krijimtarinë folkloristike

botërore nuk kam hasur një rrëfim edukimi e mësimi si gojëdhënë për Brevën dhe Oda sajbi (e publikuar më parë).

Po e shënoj gojëdhënë për mitin “Breva” të plotë, ashtu si e kam dëgjuar kur kam qenë fëmijë.

Miti për Brevën

Këtë rrëfim e kisha dëgjuar edhe në familjen tonë, por edhe në fshat, madje edhe të dajallarët (zatën, atëherë tjetërkund as që shkonim). Më shpesh tregimet na rrëfenin halla Naile dhe halla Nazime. Tregimin për Brevën na i tregonte halla Nazime, të cilën, kur ishin dyja hallat bashkë, halla Naile e qortonte hallën Nazime, duke i thënë që mos t’na i tregonte këtë përrallë se tuten fëmijët.

Le të tuten, veç të mësojnë mbi jetën, ja kthente ajo.

Legjendën nuk po e paraqes me të folmen e asaj kohe edhe pse nuk ndryshon shumë nga kjo e sodit (kohë gjysmë shekullore).

Na ishte seç na ishte një familje shumë moti, shumë larg, kur askush nuk e mban mend atë kohë.

Në ato kohë shumë të hershme jetonte një familje në kushte mbase normale për kohën, por anëtarët e saj lodheshin mjaft e që atyre u dukej si shumë e ngarkuar, ngase nuk kishin kohë për ahengje dhe duhej të punonin. Ata këtë mungesë kohe qejfi ia linin numrit të madh të fëmijëve që kishin, për të cilët duhej të punonin vazhdimisht, dihet se për nevojat e shtëpisë dhe të fëmijëve. Ata nuk po e shikonin fare se edhe jeta e të tjerëve në fshat ishte po e tillë, por ua kishte qejfi ahengun.

Kjo familje përbëhej nga një burr, një grua dhe dhjetë fëmijë. Burri e gruaja, parase të fillonin të punonin, ankoheshin në fëmijët e vet, se ata, po hanin shumë (ushqim) e spo bënin kurfarë pune. Në të vërtetë ata ende nuk ishin për punë, ngase edhe më i madhi ende ishte i mitur e i pamësuar me punët e të rriturve. Ata (prindërit) ankoheshin në shëndetin e në fuqinë e vet që nuk e kishin si qeniet mbynatyrore. Ato ankoheshin edhe në atë se, pse Zoti u kishte fal aq shumë fëmijë e t’i linte rahat në qejfë e ahengje. Pas disa ditëve që i kaluan në përditshmërinë e ankesave, ato mësuan për shtatzaninë e sërishme të gruas. Tani më nuk kishte vetëm ankesa e ide çoroditëse, por filluan të ankoheshin edhe në vet Zotin, madje her e lusnin Atë, që ta prishte këtë shtatzani e her e fyenin pse u kishte dërguar edhe një ngjizje fëmije .

Nga paknaqësia e kësaj të papriture filluan të mendonin e vepronin prishjen e atij fryti. Përdornin çdo gjë që kishin dëgjuar, madje edhe çka u tekej vet. Gruaja filloi të pinte lënjgje të idhëta, lënjgje djegëse dhe kur panë se nuk kishte rezultat, vet gruaja filloi ta godas barkun e vet që ta dëmtonte frytyn nga jashtë. Ky avaz kishte zgjatur derisa dhimbjet e shkaktuara nga goditjet që ia bënte vetës ishin bërë të padurueshme. Kur gruaja dorëzohet dhe tregon të shoqit, se nuk po mundëte të bënte më diçka tjetër në dëmtim të frytit, ai hidhërohet me gruan dhe mezi kthehet në shtëpi pas disa bredhjeve të pasukseshme. Në kohën afër lindjes, fëmijët kujdesëshin për nënën e tyre dhe pasi kthehet edhe i ati, sikur familja e merr të mbarën e cila mbarësi ridhte si veprimi lodhjes nga shamatat e përditshme.

Nuk shkoi shumë kohë dhe gruaja e lind një vajzë. E pagëzuan me emrin Brevë. Më shumë për të kujdesëshin fëmijët se sa prindërit. Herë pas here nëna përkujdesej nga pak e i ati tak (fare).

Me të dalur panvera, duhej bërë punët e fushes e të bagëtisë. Shpesh herë Brevën e linin vetëm në shtëpi të lidhur në djep me lirek. Shumë herë Breva mbetej vetëm mbase gjithditën. Me të ardhur vera bëhej më ngrohtë dhe në shtëpi bënte vapë. Brevën e merrte etja. Një ditë prej ditëve, me ndihmen e Zotit, Breva gufon në trup, lirohet nga lireku, del në oborr dhe e shqyen një pulë, e han dhe e shuan urinë dhe etjen dhe kthehet në djep me formën e mëparshme.

Kur kthehen të shtëpisë e gjejnë Brevën në gjum. E vrejten se e kishte lirekun e zgjidhur por thanë me vete se, paska qenë dikush nga fshatarët dhe e paska liruuar. Sa për mungesen e pulës, as që e vërejtën fare.

Breva, me të mbaruar pulat, filloi të ndjente mungesen e mishit. Një natë, pasi gufon e ngritet në këmbë sa një e rritur, ajo shkon në argaç të dhenëve e shqyen një dele, e han dhe kthehet në djep. Në mëngjez burri i shtëpisë tha : Breva qenka rritur shumë sa nuk po e nxika djepi. Gjysma e këmbëve i paskan dalë jashtë djepit. Meqë ishte prishur mbarvajtja (harmonia) në familje, nuk ia vuri kush veshin. Pas disa ditëve, ata e vrejten se po mungonin pulat dhe se Breva rritej me shpejtësi.

Një ditë nga ditët, ata panë se pulat ishin zhdukur. Me t'u sosur pulat, Breva vazhdon të ushqehet me dele. Ajo ngritej në mesnatë kur të gjithë ishin në gjum të thellë dhe e hante nga një dele. Si çdo herë, familja pa vërejtur gjë, shkonte në punët e veta. Me këtë rrjedhë veprimesh, Breva i hëngri të gjitha dhentë.

Breva, nuk i hante ato as si ujku e ariu, por disi bëheshin kafshët si të terura, si të thara, si të rjepura e të dërlloshkura, si të ishin të futura në drugzë, dukeshin si të brejtura.

Pas disa ditëve ajo u detyrua prej etjesë dhe urisë, të fillonte me i ngran edhe gjedhet, duke ia nisur nga të vetat. Kur ajo filloi të i ngranë edhe lopët e pastaj qetë e kuajt me radhë, të shtëpisë e hetuan dhe madje edhe e panë në veprim, por më s'kishin çka të bënin. Breva tani më kur shndërrohej, bëhej përbindëshe gjigante e bëhej shumë e fuqishëme. Ajo me metamorfozën që pësonte bëhej një lubi e vërtetë, sa familja e vet as që guxonte ta shikonte në veprim e le më ta ndalonte apo kundërshtonte.

Pas një kohe Breva i kollofiti të gjitha kafshët e shtëpisë së vet fillon të mbytë çdo gjë të gjallë te fqinjët fillimisht e më pastaj edhe të gjithë fshatit.

Breva më ishte një njeri -egërsirë sa nuk i dilej para. Fshatarët po i shihnin këto dëme, por askush nuk e kuptonte se kush po e bënte këtë dëm të këtillë dhe u larguan. Kishte mbetur vetëm familja e saj. Kur kishin mbaruar shpezët, dhent e dhinë, pastaj lopë e kuaj, thonë se ajo kishte filluar të sulmonte edhe njerëzit.

Fillon të organizohet e gjithë krahina, por më kot. Si të gjithë fshatarët e tjerë, në krahinë e më larg, kishin strehuar bashkëfshatarët e Breves, kishin pranuar edhe familjen e saj.

Breva po gjuante edhe kafshë të egra dhe kthehej tek shtëpia e vet. Ulurimat e saj tani më po i dëgjonin të gjithë dhe i kishte kapluar tmerri. Burrat më trima, që i kishin caktuar për vëzhgim e kishin vërejtur se në cilën shtëpi po kthehej ajo ditën dhe filluan të tregojnë e bisedojnë me banorët e tjer.

Prindërit e Brevesë vetëm dëgjonin. Por një vëllai saj tregon se ajo ishte motra e tij. Atëher ishte mbledhur paria dhe kishin marrur vendim që prindërit e Brevesë t'i kthenin në shtëpi të vet dhe se për ta mos të bënte askush strehë e as konak vetëm për prindërit. Meqë ishte stinë dimri dhe nuk mund të mbijetonin në natyrë, ata u detyruan të shkonin në shtëpi të tyre.

Gjatë kthimit, nga frika që kishin ata (prindërit e Breves), filluan të luteshin te Zoti që mos t'i gjente gjë e keqe. Kur u futen në oborr po bënte një ftoht i madh. Me frikë u futen brenda. Breva dukej se po flinte. Prindërit e saj u ulen pran murit përballë saj dhe po luteshin që ajo mos të zgjohej. Mirëpo Breva pas pak i hapi sytë e po i shikonte. Pastaj u ngrit në këmbë dhe drejtohet kah ata. Nga frika që deri atëherë i luteshin Zotit, ata filluan t'i luteshin asaj. Ajo ecte nëpër dhomë dhe herë pas herë ua lëshonte sytë dhe lëshonte ca fërshëllima nga goja, të cilat nuk ishin as zë i plotë e as fishkëllimë.

Prindërit e saj po dridheshin nga frika dhe vetëm po i luteshin asaj. Kur e panë se ajo nuk po kuptonte gjë, ose bëhej se nuk po kuptonte gjë, filluan prap t'i luteshin Zotit që t'i shpëtonte nga ajo përbindëshe. Orët po kalonin dhe Breva as po i hante e as po i lente të qetë. Ata, aq

shumë u lodhën e u cflitën sa filluan të pajtoheshin me fatin e tyre se, vajza e tyre Brevë duhë t'i hante. Brevë filloi të nxirrte një tingull më të artikuluar i cili i dilte në formë kërcënimi e herë-herë si lloj vajtimi. Tingulli si i vajtimit i dilte kur e kishte shpindën të kthyer nga prindërit, kurse në formë kërcënimit i dilte atëherë kur i shikonte. Kishin kaluar disa orë. Kur ata më veç dukeshin si në delirium, burrit iu kujtua që Brevën ta qetësonte si prind që ishte dhe iu drejtua.

-Mos bij e babës, i tha i ati, ne nuk kemi faj. Zoti të ka krijuar të tillë...

Mbase donte t'i thoshte edhe diçka, por Brevë në formë kërcënimi uluriu dhe iu afrua edhe më shumë se hera tjera. Burrit i mbesin fjalët në fyt dhe nga frika e kthen kokën anësh, që, së paku mos ta shihte duke e kafshuar. Por pas disa çasteve e pa se ajo ishte larguar dhe po zhurmonte në skajin tjetër të dhomës. Me të parë se ajo ishte larguar, burri filloi që ta përsëriste refrenin e më parshëm, por Brevë nuk qetësohej, por vinte sikur në të kërcyer afër e më afër se herat tjera.

-M'u bashko në këto fjalë, i tha burri gruas së tij.

-Në cilat fjalë, i tha ajo?

-Se është bija e jonë dhe se Zoti e ka krijuar si të tillë, ia ktheu ai.

-Jo mor burrë, i tha e shoqja. Zoti e fal si të tjerët, por ne nuk u kujdesëm sikur për të tjerët dhe për këtë Zoti po na dënon.

Pas këtyre fjalëve, në mesin e tyre filloi një polemik nga e cila ata (gruaja dhe burri) nxorrën të gjitha veprimet që kishin bërë për të mos lindur ai fëmijë dhe të gjitha pakujdesitë që i kishin bërë ata pas lindjes së saj.

-Kjo është një provë për mosçiltërsinë tonë, tha gruaja.

-Është mosmirënjohja e jonë ndaj Zotit, tha burri.

-Është jodevotshmëri ndaj Zotit, tha gruaja.

-Është pabindshmëri ndaj Zotit, tha burri.

Sikur heshtën për një çast, por gjatë heshtjes së tyre Brevë filloi të transformohej (të bëhej edhe më e trishtueshme, thoshte plaka Nazime Hamiti), ata lëshuan ca klithje duke menduar se ishte më fundi i tyre.

-Të lutem Zot na fal, tha si me ndërprerje e ëma e Brevës.

-Të lutem Zot prano pendimin tim, tha i ati i Brevës.

-Më fal mua edhe Brevën, tha e ëma, ngase ajo nuk ka faj për dëmet që ia kemi bërë ne.

Të njëjtat fjalë i përsëriti edhe i ati. Brevë sikur u qetësua pak dhe u largua paksa prej tyre.

-Të lutemi s'bashku te Zoti që ai t'na i pronoj pendimin parase të na mbysë Brevë.

Ata ngritën duar në formë amini dhe futën kokat në mesin e tyre dhe vetëm po luteshin për pendim. Ata më as që po shikonin në drejtim të Brevës. Duke u lutur u rodhën lotë faqeve. Duke qarë e duke u lutur ata as që e kishin vërejtur se ishte ndalur zhurma e Brevës.

Pas ca çasteve ata dëgjuan një zë të mitur fëmije i cili po i thërriste: -nanë, babë. Pas dytri thirrjeve të këtilla, ata ndalin lutjet dhe i përkushtohen zërit që po i thërristes. Por nuk mund të shihnin gjë nga terri i natës dhe nga lotët që kishin derdhur. Drita e dritarës që ishte mjaft lartë dhe përmes së cilës dritë ata i shihnin lëvizjet e Brevës, nuk po sqaronte diçka të qartë.

-Ndeze pishën, i tha burri gruas.

-Spo më bëjnë gujtë, i tha e shoqja, por prap filloi të ngritej duke u mbajtur për muri dhe tha:

-Po ku shkoi Brevë, bija e nënës, nuk e pashë kah doli, dhe veç më ishte në këmb.

-Nuk di, i tha burri, ngase kjo thirrje m'i mori mendët.

Pas pak e ëma e Brevës arriti të ndehte pishën dhe dhoma u ndriçua.

Çfarë të shihnin! Një vajzë e vogël dhe e bukur si nuri po qëndronte pranë tyre duke qeshur. Këtu jam, tha ajo.

-Nëna ime, i tha ajo sikur fëmijët kur shqiptojnë fjalët e para dhe iu hodh në qafë. Ashtu iu drejtua edhe të atit dhe prind e bijë filluan përqaqimet e vajtimet dhe marrin rrugën e mbarë të jetës, pasi që Zoti kishte pranuar pendimin e tyre.

“Përralla u tregoftë e jeta me të mirën vazhdoftë”.

Nuk ka nevojë të shkruaj diçka për përfundimin e kësaj rrëfenje.

Literatura e konsultuar:

- Kanuni i Lekë Dukagjinit (E drejta zakonore shqiptare 1), përgatitur dhe pajisur me shënime nga Koço Nova, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: , Tiranë 1999,

-Shala, Demush, Këngë popullore historike, “Rilindja”, Prishtinë 1973

Гилгамеш, издавач Матица Македонска, Скопје, 2006, уредник Раде Силјан, препеал на македонски Паскал Гилиевски

Рамајана, Индиски еп, Скопје 2007, ISBN 978-9989-33-254-8

-Махабхарата, Индиски еп, Скопје 2007, ISBN 978-9989-33-278-4

Virgjili “Eneida”, Rilindja, Prishtinë, 1981

Burimet:

- [1]. Rrëfimet janë marrë nga shumë njerëz të Malësisë së Karadakut, ku kjo legjendë tregohej me të shpesht. Legjenda për Brevën rrëfehej në Malësinë e Kumanovës, të Gjilanit, Vitisë, Preshevës ku e kam dëgjuar vet disa herë, por përmendët edhe sot e kësaj dite.
- [2]. Për formën, mënyrën e rrëfimit e kam marrë nga dy lokmëdhat e katundit tonë Kron (Izvor): Naile Murati dhe Nazime Beqiri.